



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 4103/2023
Data: 17.05. 2023

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e katër –IV- për vitin 2023 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 26.04.2023 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Kryesuesi konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Komunitete. Prezent ishte : Vaid Daci (Zyrtar i Zyrës Kadastrale)

RENDI I PUNËS

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Takim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- 3.Takim me Zyrtarin e Zyrës për barazi gjinore (Lufta kundër dhunës)
- 4.Takim me Zyrtarin e Zyrës Kadastrale.
- 5.Eventuale.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin. nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

Zaim Bela thekson:- Është mirë procesverbalet të shkruhen më gjerësisht, gjithashtu këtu në materialin e drejtorit të arsimit shihet që drejtoria e arsimit kulturës rinis dhe sportit donë me e nda drejtorinë në dy drejtori drejtoria e arsimit dhe drejtoria e kulturës rinis dhe sportit ndërsa drejtoria e zhvillimit ekonomik donë me e shtuar edhe turizmin ku e përgëzova për këtë , po tek drejtoria e arsimit duhet me buxhet e vitit aktual por me planifikim te vitit 2024 ku me u formuar 9 drejtori unë veç ju njoftova pasi që kemi me e votuar në kuvend.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Kryesuesi thekson:- pasi që Drejtori i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk është prezent kalojmë në pikën e tretë të rendit të punës.

3. Takim me Zyrтарin e Zyrës për barazi gjinore (Lufta kundër dhunës)

Kryesuesi thekson:- pasi që Zyrтарi i Zyrës për barazi gjinore, nuk është prezent kalojmë në pikën e katër të rendit të punës.

4. Takim me Zyrтарin e Zyrës Kadastrale.

Kryesuesi thekson:- në një kuvend në vitet e kaluar mbaj mend ku thuhej që mbrapa entit social janë 16 ari a janë në kadastër apo si është puna e tokave në atje pjesë ? Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Vaid Daci thekson:- një parcele në tërësi nuk mundem me than sa ari është por si pronësi është në emër të komunës.

Kryesuesi thekson:- ato persona që janë me banesa në atë pjesë si jetojnë ?

Vaid Daci thekson:- banesat ndahen në dy pjesë pronësia e parcelave dhe pronësia e ndërtesave këto banesa janë të ndërtuara nga ish jugosllavia janë të regjistruar në kadastër kati i banesës apo metra katror janë të regjistruar në kadastër ndërsa toka ku janë të nderuara janë në pronë të komunës edhe komunat e tjera e kanë këtë problem edhe po të behet me i`a dhënë ndonjë investitorit me ndërtuar por nuk pranon sa është aq e vogël prona komunale.

Kryesuesi thekson:- disa banesa më herët kanë qenë të ndara ku kanë jetuar komiteti rom ato janë shit ato janë barte kur ka qenë shtetërore dhe a ka ndonjë tokë të uzurpuar.

Vaid Daci thekson:- tokë të uzurpuar komplet nuk ka po pjesë pjese ka raste qe ka, ndërsa sa ju përket banesave ku kanë jetuar komiteti rom në vitet 2010 ka qenë kur është bërë kadastri i ndërtesave ku shumica kanë pas kontrata.

Kryesuesi thekson:- a ka ndonjë qytetar ku shqepin e ka të ndërtuar në pronë të komunës

Vaid Daci thekson:- nuk e di një gjë të tillë.

Hanumshahe Dibrani thekson:- pikat kadastrale të shtëpive a janë në rregull sepse kam informacione që shumica e shtëpive nuk i kanë pikat në rregull.

Vaid Daci thekson:- në komunën tonë planet kadastrale që janë bërë në vitin 1969 e kemi me shkallë zvogëlimi 2500 ku do të thotë që janë zvogëluar 2500 herë ai plan deri sa ka dal në vijë digjitale pika , shumica e pronave janë që kanë telashe nuk është faji në kadastër por faji është kur është bërë ai incizim nga vitet e me hershme por në shumicën e rasteve palët arrijnë me e pas një mirëkuptim po nëse nuk kanë mirëkuptim vazhdojnë me gjykatë

Zaim Bela thekson:- sa është toleranca ?

Vaid Daci thekson:- toleranca është deri 1m

Ajnure Thaqi thekson:- a ka raste ku një x person ka shit tokën dhe personi që e blen ndërton dhe tatimi i shkon pronarit të vjetër ?

Vaid Daci thekson:- po ka raste para disa dite kisha të njëjtin rast.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

5.Eventuale

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hanumshahe Dibrani thekson: Që dy dite kemi problem me ujë është mirë të dihet arsyeja e ndaljes.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në 14:55

Procesmbajtësja
Sara Berisha



Kryesuesi i Komitetit
Metajl Suma

